Kronikë

Të shtëna me armë zjarri në një lokal në Shkodër, 47-vjeçari i plagosur shkon vetë në spital, mori plumb në shpatull

Të shtëna me armë janë regjistruar mesditën e kësaj të premteje në lagjen Skënderberg në Shkodër, ku për pasojë është plagosur një 47-vjeçar. I plagosuri i cili ndodhej në lokal në momentin e ngjarjes mori një plumb në shpatull dhe i gjakosur shkoi në spitalin rajonal të Shkodrës.

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Gerbuma

Redaksia
11 Gusht, 13:01 | **Përditësimi: 11 Gusht, 13:39**

SHKODËR- Të shtëna me armë janë regjistruar mesditën e kësaj të premteje në lagjen Skënderberg në Shkodër, ku për pasojë është plagosur një 47-vjeçar. I plagosuri i cili ndodhej në lokal në momentin e ngjarjes mori një plumb në shpatull dhe i gjakosur shkoi në spitalin rajonal të Shkodrës.

Ishin 'bluzat e bardha' që raportuan policinë e Shkodrës e cila pas njoftimit rrethoi zonën.

LEXO EDHE:
VIDEOLAJM/ Mbeti në shtegun Theth-Valbonë, shpëtohet me helikopter turistja spanjolle shtatzënë

Aktualisht Odri është duke marrë trajtimin mjekësor përkatës në spital dhe ndodhet jashtë rrezikut për jetën. Sidoqoftë, ngjarja është ende shumë e paqartë. Odri nuk ka pranuar të flasë për dinamikën e ngjarjes në spital.

Aktualisht po hetohet mbi shkaqet dhe rrethanat e kësaj ngjarjeje. Deri tani nuk ka treguar gjë mbi dinamikën se çfarë dhe si ka ndodhur.

Grupi hetimor vijon veprimet për sqarimin e rrethanave të këtij rasti, si dhe për identifikimin dhe arrestimit e autorit/ëve të tij.

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 13:27

Plagosja në Shkodër, ja çfarë thotë policia! 'Blutë' rrethojnë zonën

Policia ka raportuar për ngjarjen që ndodhi ditën e sotme në Shkodër.

Shkodër/Informacion paraprak

Rreth orës 12:44, në sallën operative të Policisë së Shkodrës, ka mbërritur një telefonatë nga Spitali Rajonal i Shkodrës, se është paraqitur për ndihmë mjekësore dhe është jashtë rrezikut për jetën, shtetasi F. O., 47 vjeç, banues në fshatin Grudë e Re, i cili në një rugicë në afërsi të një lokali, në lagjen "Skënderbeg", në rrethana ende të paqarta, është plagosur me armë zjarri, në shpatull.

Shërbimet e Policisë kanë rrethuar zonën dhe vijon kontrolli i saj.

Grupi hetimor vijon veprimet për sqarimin e rrethanave të këtij rasti, si dhe për identifikimin dhe arrestimit e autorit/ëve të tij.

G.MO/Shqiptarja.com

G.MO/Shqiptarja.com

TAG: Shkodër plagosje fatmir odri

Komentoj

Komente

Shkodra: 11/08/2023 13:49

E paska ruj zoti kte rrezikun se ja paskan nis Per kry e paska xan n'shpatull.. Po shyqyr kaiher sdine me gjujt mire Kto plenat qe mbeten tu u vra perdite njerez kot. Meqe ra fjala kapni kto kriminelat qe i keni rrugeve Se asnje skemi kap, kapni kot do njerz ushtar pa lidhje E shofera fruta perimesh e ngarkim sikarkim Dhe kto qe ushqejne kafshet kuaj e qen..

Përgjigju

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Siguria në plazhe krahasuar me një vit më parë është:

Më mirë | Më keq | Njësoj

Lajme të tjera



Ish-kreu i Bashkisë së Fushë Arrëzit dhe dy të tjerë dërgohen për gjykim! SPAK: Hapën rrugë mes pyllit pa leje, dëmi 234 mln lekë

16 Gusht, 09:27

Tragjedi në Himarë, katër adoleshentë përplasin jet skitë në det! 16-vjeçari në reanimacion në gjendje të rëndë, plagoset shoku i tij pasagjer

15 Gusht, 17:24



VIDEO/ Kishin mbetur të bllokuar në një terren të thepisur në përroin e Cutit, shpëtohen 2 turistë francezë në Shkodër

15 Gusht, 12:06

Sherr për ngacmimin e një vajze 3 vite më parë, 35-vjeçari plagos me thikë dy vëllezërit në Tiranë! Arrestohet në një hotel në Lushnjë, i gjendet kokainë

14 Gusht, 09:09

'Me not drejt lirisë', heronjtë antikomunistë kujtojnë 20 të rinj shkodranë që tentuan arratisjen nga liqeni i Shkodrës

Ergys Kavaja

12 Gusht, 18:18

Operacioni anti-drogë në Shkodër, Lezhë, Krujë dhe Tropojë! Dronët zbulojnë mbi 20 mijë rrënjë kanabisi, 1 në pranga dhe 10 në kërkim

11 Gusht, 11:01

Vau i Dejës/ Kishin kultivuar 2100 rrënjë kanabis mes parcelës me misër, arrestohet 25 vjeçari (VIDEO)

10 Gusht, 11:50

Tifozët i hapin probleme, UEFA gjobë të majme për Vllazninë

10 Gusht, 09:50

E rëndë në Fushë Arrëz, 6-vjeçari mbytet në rezervuarin e Iballës! Policia: Familjarët e nxorrën, por s'mbijetoi dot

9 Gusht, 21:26

'Rikthim në traditë', ekspozohen veshjet popullore shqiptare në Shkodër! Trashëgimia përmes narrativës kostumografike

Ergys Kavaja

9 Gusht, 16:22

'Filizat e shkulur'! Vllaznia largon talentin e ekipit, firmos në Vlorë

9 Gusht, 12:27

Trafiku i rënduar në aksin Shkodër – Tiranë, Rama: Do ta vuajmë edhe pak mungesën e 'Korridorit Blu'! Shqipëria turistike bregdetare do jetë krenaria jonë

9 Gusht, 10:20

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje